



THE AIRE CENTRE
Advice on Individual Rights in Europe



**REGIONAL
ANTI-CORRUPTION
INITIATIVE**

Rast Studimi

Malit

- Prodhimi, posedimi dhe shitja e
paautorizuar e drogave narkotike -



Krimi: Prodhimi, posedimi dhe shitja e paautorizuar e drogave narkotike

- Individi është dënuar për veprën penale të prodhimit, posedimit dhe shitjes së paautorizuar të drogave narkotike në përputhje me nenin 300(1) të Kodit Penal të Malit të Zi;

- Konfiskimi i apartamentit P=64 m²;

- Gjykata vërtetoi përtej dyshimit të arsyeshëm se prona në fjalë ishte fituar përmes kimit;

- I dënuari pretendonte se apartamenti ishte në pronësi të tezes së tij, e cila banonte në Gjermani dhe thjesht ishte i regjistruar në emër të tij. Tezja kishte një marrëdhënie të keqe me të shoqin dhe donte të sigurohej që banesa në vendlindjen e saj të mos ishte pjesë e pasurisë bashkëshortore, nga e cila ajo do të duhej të hiqte dorë nga gjysma në rast divorci;

- **Neni 16(2)** i Ligjit për Konfiskimin e të ardhurave të veprës penale (provat e mbledhura gjatë hetimit penal mund të përdoren në hetim financiar); u përgjuan dy biseda përmes masave të fshehta të vëzhgimit dhe të lidhura me hetimin financiar:

Biseda I: Nëse ndodh ndonjë gjë, duhet të verifikoni që më keni dhënë lekët e banesës;

Biseda II: Nuk do të shkoj në shtëpi sot, sepse më ka ardhur nëna dhe ajo do të flejë në shtëpi;

- Gjykata arriti në përfundimin se ai e konsideronte apartamentin si të tijin dhe se tezja nuk ia kishte vënë kurrë në dyshim këtë gjatë bisedës një gjë të tillë;

- Ai nuk kishte të ardhura.